



REPUBLIKA KOSOVË/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	2-D/DPK
Dep.	Nr. Prot.
Dep.	Br. Prot.
Nr. Ifaq	Prot No.
Broj stranica	01-4771/15
Nr. pages	02
Data Datum Date	
14.12.2015	
PRISHTINË	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 11.12.2015, mori:

**V E N D I M**

**I. Mylllet rasti me nr. AKK-03-02-2949/15, për zyrtarin e lartë z. Ardian Arifaj, Këshilltar Politik ne Zyrën e Kryeministrat të Republikës se Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshëm të Konfliktit të interesit.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-2949/15,qe për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Ardian Arifaj, Këshilltar Politik, Zyra e Kryeministrat të Republikës se Kosovës.**

Gjatë procesit për identifikimin e rasteve të dyshuara për konfliktit të mundshëm të interesit, është identifikuar rasti për zyrtarin e lartë, Ardian Arifaj, Këshilltar Politik në Zyrën e Kryeministrat të Republikës se Kosovës.

Gjatë kontrollit te formularëve te deklarimit te pasurisë është vërejtur se zyrtari i lartë ka të regjistruar një biznes privatë dhe figuron si person i autorizuar ne ketë biznes e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 07.10.2015, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Ardian Arifaj, ka ardhur ne zyrat tona ku nga zyrtarët e AKK-së, është njoftuar për situatën ne të cilën gjendet si dhe me provat dhe faktet qe posedon AKK-ja.

Zyrtari i lartë z. Arifaj, gjatë takimit është pajtuar me gjendjen, por është zotuar se brenda afatit ligjor do të bej ndryshimet dhe do te veproj sipas ligjit ne fuqi për ta parandaluar situatën e mundshme te konfliktit te interesit, pasi qe për ketë çështje nuk ka qen i njoftuar sepse do ti kishte ber me kohë këto ndryshime.

Me datën 10.12.2015, kemi pranuar dokumentin zyrtar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se z Ardian Arifaj, nuk figuron me si person i autorizuar ne biznesin "N. SH- PIAR-1" me numër 70770245.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Ardian Arifaj, Këshilltar Politik, në Zyrën e Kryeministrit të Republikës se Kosovës, dukë ber ndryshimet ne biznesin privat, duke u larguar nga personi i autorizuar në biznesin e tij, janë krijuar rrëthana të reja dhe konstatojmë se është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë ne ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Ardian Arifaj, Këshilltar Politik në Zyrën e Kryeministrit të Republikës se Kosovës, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrëthana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtoret të DPK- së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari kontaktues )

Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

